



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI**

---

Numri i lëndës: 2021:261971  
Datë: 21.02.2025  
Numri i dokumentit: 06884962

E.nr.260/10

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Telekom i Kosovës Sh.A (ish PTK sh.a), Dardania pn, me seli në Prishtinë, ndaj debitorit Rr.A nga Vushtrria rruga “...” nr.46, jashtë seance me datë 21.02.2025 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

PËRFUNDOHET procedura përmbartimore e kreditorit Telekom i Kosovës Sh.A (ish PTK sh.a) “Dardania” pn, me seli në Prishtinë, ndaj debitorit Rr.A nga Vushtrria rruga “...” nr.46, për pagesën e borxhit në shumën prej 126.57 euro dhe shumën prej 15 euro në emër të taksës gjyqësore, për shkak të tërheqjes së propozimit nga kreditori.

**A r s y e t i m**

Kreditori Telekom i Kosovës Sh.A (ish PTK sh.a) “Dardania” pn, me seli në Prishtinë, me datë 12.05.2010 ka parashtruar propozim për përmbartim ndaj debitorit Rr.A nga Vushtrria rruga “...” nr.46, bazuar në dokumentin e besueshëm-faturave, për pagesën së borxhit në shumën prej 126.57 euro dhe shumën prej 15 euro në emër të taksës gjyqësore.

Gjykata e ka lejuar përmbartimin me datë 22.06.2010.

Gjyqtari i çështjes është ngarkuar më këtë lëndë me datë 21.04.2022.

Përfaqësuesi i kreditorit me njoftimin elektronik të datës 21.02.2025, deklaroi se debitori e ka përmbushur në tërësi borxhin dhe taksën gjyqësore, andaj e tërheq në tërësi propozimin për përmbarim duke kërkuar që të bëhet edhe deblokimi i llogarisë personale bankare të debitorit.

Marr parasysh të lartcekurat, bazuar në nenin 42 par.2 lidhur me nenin 66 par.4 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË- DEGA NË VUSHTRRI**

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

CP.nr.260/10, me datë 21.02.2025

Gj y q t a r i

Jeton Zymeri

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi lejohet e drejta në ankesë në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate.